

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
NR.13823 REP 1562 KOL.



KONTRATE E SHITBLERJES  
(KUOTAT E KAPITALIT THEMELTAR)

Ne Tirane, ne zyren e noterise, ne rrugen "Ismail Qemali" P.27/1, sot me date 20.12.03, para meje noter Agim Robo paraqiten personalisht, palet kontraktuese me cilesite e meposhteme:

**SHITESI:** Bardhyl Hysenbelliu, biri i Hasanit dhe Fiqiretes, dl.27.05.1967, banues ne Tirane, rruga "Vaso Pasha" nr.8, me pasaporte nr.1594572.

**BLERESI:** Irfan Hysenbelliu, biri i Hasanit dhe Fiqiretes, dl.08.04.1959, banues ne Tirane, rruga "Vaso Pasha" nr.8, nr.pasaportes 1762730.

Me zotesi te plote juridike e per te vepruar qe me vullnetin e tyre te lire kerkuan redaktimin e aktit noterial te shitblerjes se kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise tregetare "HYSENBELLIU" sh.p.k.

**PERMBAJTJA E KONTRATES:**

**SHITESI**, zoti Bardhyl Hysenbelliu eshte Ortak i Vetem i shoqerise tregetare "HYSENBELLIU" sh.p.k., me kapital themeltar 100.000 njeqinde mije leke, rregjistruar si person juridik me vendim nr.19.596 date 11.06.1998 ne Regjistrin Tregetar. Sipas vendimit nr.1 date 20.12.03, te Ortakut te Vetem, ky i fundit ka vendosur "Transferimin e kuotave te tij te kapitalit themeltar tek Bleresi zoti Irfan Hysenbelliu." Me marveshje te paleve kontraktuese shlyhet vlefte e plote e kuotave prej 100% te kapitalit themeltar, vlere nominale e te cilave eshte 10.000 leke dhjete mije leke.

**BLERESI** zoti Irfan Hysenbelliu, pranon blerjen e kuotave prej 100% nepermjet shitjes dhe me shlyerjen e plote te vlefte, ai behet zoterues i tyre si dhe Ortak i Vetem i shoqerise se mesiperme "HYSENBELLIU" sh.p.k.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate dhe shlyerjen e vlefte se shitjes, z Bardhyl Hysenbelliu humbet zoterimin mbi kuotat e kapitalit themeltar dhe njekohesisht edhe cilesine e Ortakut te shoqerise duke mos patur me asnje te drejte pronesie mbi te.

Sa me siper kontrata e shitblerjes u redaktua ne baze te nenit 45 te Ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare". Kontrata iu lexohet paleve me ze te larte, ata deklarojne se e kuptojne permbajtjen e saj dhe nenshkruajne ne fund pa asnje verejtje.

Une noteri redaktova kontraten e shitblerjes ne perputhje me vullnetin e tyre te lire dhe pasi e gjej aktin ne pajtim me ligjin, nenshkruaj dhe vertetoj rregullisht.

PALET

**SHITESI**  
**BARDHYL HYSENBELLIU**

*Bardhyl Hysenbelliu*

**BLERESI**  
**IRFAN HYSENBELLIU**

*Irfan Hysenbelliu*

*Agim Robo*

